



Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality  
**Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport**



**Dragash, 18.06.2021**

**Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport u bën:**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit - Opština Dragaš

Marrë në dërgim		18.06.2021	
Primitje			
№	Emri	№	Emri
01	644/01	17418/21	

**THIRRJE PUBLIKE**

1. Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare mbi:

✓ Organizimin e Festivalit Folkloriko-Burimor "Opoja Vallëzon"

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare:

Shuma maksimale e mbështetjes financiare që mund të aplikohet për këtë projekt është **12.000 euro**.

3. Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë artistike të projektit;
6. Origjinalitetit të projektit.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- ✓ Formulari i aplikacionit për projekt/ program
- ✓ Formulari i propozim-buxhetit

- ✓ Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
- ✓ Formulari për konflikt interesi
- ✓ Dokumenti identifikues (fotokopje e shtypur)
- ✓ Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje e shtypur)
- ✓ Konfirmim nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit
- ✓ Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
- ✓ Dëshmi të implementimit projekteve/ programeve të ngjashme

5. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **18.06.2021 deri më 08.06.2021 (15 ditë pune)**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

**Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Prokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit  
Për: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.**

## **6. Aplikimet**

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në teritorin e Komunës së Dragashit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit.
4. OJQ-të duhet poashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
7. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

**Vërejtje:**

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen dhe në mënyrë elektronike, duke dërguar email në adresën [dkrs.dragash@gmail.com](mailto:dkrs.dragash@gmail.com)

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport



**Ljirim Hajredini**